



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 52

Prishtinë, më 5 tetor 2012, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Nazane Breca, Time Kadriaj, Gëzim Kelmendi, Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Flora Brovina, Liburn Aliu

Mungoi: Sasha Gjokiq.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj- administratore e Komisionit; Enis Halimi- zyrtar i fushës për shëndetësi.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 26.09.2012;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit të monitorimit të Ligjit të punës;**
- 4. Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 26.09.2012

Komisioni vendosi që miratimin e procesverbalit të datës 26.09.2012 ta shtyjë për mbledhjen e radhës.

3. Shqyrtimi i Raportit të monitorimit të Ligjit të punës

Fikrim Damka- Tha se sot do ta shqyrtojmë Raportin e monitorimit të Ligjit të punës. Fjalën ia dha kryesuesit të grupit të punës për monitorimin e Ligjit të punës, z. Liburn Aliut.

Liburn Aliu- Tha se ky raport është i hartuar mbi bazën e gjetjeve që i kemi hasur si grup i punës dhe jo si rezultat i gjetjeve individuale. Ne mund ta modifikojmë këtë raport me të dhëna të tjera. Një ndër problemet e këtij ligji është mosfunksionimi i Këshillit Ekonomiko-Social. Sindikatat në këtë Këshill, vazhdimisht mbivotohen nga përfaqësuesit e Qeverisë dhe punëdhënësve. Qeveria, në shumicën e rasteve, është në anën e punëdhënësve. Për këtë arsye, dua që të funksionalizohet më mirë Këshilli Ekonomiko- Social.

Salihe Mustafa- Tha se Ligji për Këshillin Ekonomiko-Social e parasheh një formë të tillë të përfaqësimit. Të mos futemi në debate politike. Ligji po zbatohet. Ne si Komision e kemi miratuar Ligjin për Këshillin Ekonomiko-Social. Ligjet bëhen për shtet dhe jo për Qeverinë.

Nazane Breca- Tha se nëse vërehen mangësi në ndonjë ligj, ne duhet ta evidentojmë në raport.

Flora Brovina- Tha se formimi i Këshillit Ekonomiko-Social është një e arritur e jona. Sindikatat te ne janë të dobëta dhe për këtë ka shumë faktorë. Këshilli duhet të ketë përfaqësim të balancuar.

Bahri Thaçi- Tha se ne duhet të kemi propozim konkret për përmirësimin e kësaj gjendje në Këshillin Ekonomiko-Social.

Time Kadriaj- Tha se ne duhet ta diskutojmë këtë raport ndërmjet vete. Si Komision, duhet të dalim me një qëndrim dhe jo të kemi qëndrime të ndryshme. Ne mund të japim si rekomandim që të respektohet neni 48 i Ligjit të punës. Nuk duhet që t'i japim shkas dikujt që ta ndryshojë këtë nen.

Flora Brovina- Tha se unë kam pasur shumë takime lidhur me këtë çështje. Punëdhënësit kërkojnë që të ndahen obligimet e pushimit të lehonisë në mënyrë proporcionale me Qeverinë.

Liburn Aliu- Tha se këtë e kemi evidentuar në pjesën e raportit ku flitet për problemet me ligjin.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri miratoi Raportin e monitorimit të Ligjit të punës.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka